



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.** **Tiranë 04/04/2020**

Nr. Dok. (*Dërgohet paraprakisht në rrugë elektronike*)

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave të menjëherëshme, për moscënimin joproportional të së drejtës për hyrje në territor të shtetasve shqiptarë që kanë mbetur të bllokuar në kufirin tokësor me shtetin grek dhe shtetin malazez, për shkak të masave të veçanta administrative të marra gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Drejtuar:

KOMITETIT NDËRMINISTROR TË EMERGJENCAVE CIVILE

Tiranë

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Tiranë

Për dijeni:

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë

PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit është duke monitoruar me shumë vëmendje masat e marra nga autoritetet shqiptare për të mundësuar riatdhesimin e një numri shtetasish shqiptarë të cilët si pasojë e mbylljes së kufijve kanë mbetur jashtë vendit, apo edhe kushtet e lëvizjes së tyre, pasi hyjne në kufijtë shqiptarë, kryesisht tokësorë.

Të vetëdijshëm për situatën e vështirë në të cilën gjendet vendi, ashtu sikundër edhe shumë vendeve të tjera të botës, si edhe duke mirëkuptuar vështirësitë me të cilat ndeshen autoritetet shqiptare në zbatim të planit të masave për të mundësuar identifikimin dhe riatdhesimin e shtetasve shqiptarë, dëshirojmë të përsërisim thirrjen tonë, por edhe të autoriteteve më të larta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, që kjo situatë të mos kthehet në shkelje apo kufizimin sistematik të disa të drejtave apo lirive themelore të shtetasve shqiptarë, të cilat nuk janë kufizuar as në kuptim të nenit 175 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjatë monitorimit të masave të marra për trajtimin e shtetasve shqiptarë të cilët kanë shprehur kërkesën për t'u rikthyer në Shqipëri, vendin e tyre, kemi vërejtur me shqetësim se qëndrimi i autoriteteve shqiptare është në disa raste në tejkalim të skajshëm të normave dhe parimeve themelore të Kushtetutës dhe akteve të tjera të legjislacionit shqiptar dhe instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë dhe mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Para se të analizojmë detyrimet dhe kufizimet që parashikojnë aktet ndërkombëtare dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, lidhur me të drejtën e shtetasve për të hyrë në territorin e shtetit të tyre, do të ndalemi shkurtimisht tek nocioni i shtetësisë dhe detyrimet e shtetit si "kujdestar" i shtetasve të tij.

Në aktet juridike ndërkombëtare shtetësia përcaktohet si një lidhje e përhershme juridike e personit fizik ndaj shtetit, pavarësisht nga fakti në se ai ndodhet brenda apo jashtë kufijve të tij, përmbajtja e së cilës shprehet në tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella në marrëdhënie midis tyre. Shtetasi i një shteti të caktuar është nën mbrojtjen e tij edhe jashtë kufijve të atij shteti. Nga ana tjetër, kudo që ndodhet, ai është i detyruar që të përmbushë të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit të vet.

Neni 2 i Konventës Evropiane për Shtetësinë¹ parashikon se: *"Shtetësi" do të thotë lidhja juridike ndërmjet një personi dhe një shteti dhe që nuk tregon origjinën etnike të personit.*

Në ligjin nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare"- i ndryshuar, ajo përcaktohet si *"një lidhje e qëndrueshme juridike, që shprehet në të drejtat dhe detyrat e ndërsjella të personit fizik dhe të shtetit shqiptar"* (paragrafi 1 i nenit 1).

E drejta e shtetasve për të mos u penguar të hyjnë në territorin e shtetit të tyre (dhe detyrimi i shtetit për të mos penguar shtetasit) është një nga të drejtat që u njihet atyre nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 13, pika 2)², Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile

¹ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8942, datë 19.09.2002.

² Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.

dhe Politike (neni 12, pika 4)³, si dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 3/1 i Protokollit nr.4).⁴

Aktet e lartpërmendura, si ato të legjislacionit shqiptar ashtu edhe ato me karakter juridiko-ndërkombëtar, nuk e përjashtojnë mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme. Por kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përgjithësisht legjitimohet vetëm në rastet e një gjendje jashtëzakonisht të nevojshme që dikton nevojën e kufizimit, për mbrojtjen e një interesi më të lartë se ai i të drejtave që kufizohen. Por, siç do të paraqesim në vijim, edhe e drejta e kufizimit nuk është e palimituar.

Neni 12 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, parashikon se:

Neni 12

1. Secili që ndodhet ligjërisht në territorin e një shteti ka të drejtë të lëvizë lirisht brenda këtij territori si dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

2. Secili është i lirë të braktisë cilindo vend, duke përfshirë edhe vendin e tij.

3. Të drejtat e sipërpërmendura mund të kufizohen vetëm kur kjo parashikohet me ligj, dhe kur është e nevojshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare, rendin publik, shëndetin ose moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve, si dhe kur këto kufizime janë në përputhje me të drejtat e tjera të njohura në këtë Pakt.

4. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga e drejta për të hyrë në vendin e tij.

Qartësisht, kjo dispozitë autorizon shtetet palë për të vendosur kufizime në lidhje me të drejtën e lëvizjes lirisht brenda apo jashtë territorit (pika 3), por jo në lidhje me të drejtën e shtetasve për të hyrë në vendin e tyre.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), neni 3/2 i Protokollit 4 parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet e drejta për të hyrë në territorin e Shtetit, shtetas i të cilit ai është. Të drejtat e parashikuara nga KEDNJ mund të kufizohen nga shtetet vetëm në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, me kusht që këto masa të mos jenë të papajtueshme me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare, si edhe duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për këto kufizime, ose ndryshe për derogimin nga disa të drejta të parashikuara nga Konventa, (neni 15 i Konventës).

Kjo afirmohet edhe në nenin 17 të Kushtetutës së RSH, e cila përcakton shprehimisht se:

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

³Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga e drejta për të hyrë në vendin e tij.

⁴Askujt nuk mund t'i hiqet e drejta për të hyrë në territorin e Shtetit, shtetas i të cilit ai është.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 175) parashikohet se cilat janë të drejtat që mund të kufizohen dhe ato që nuk mund të kufizohen gjatë gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Kushtetuta qartësisht dallon midis llojeve të të drejtave që mund të kufizohen në rastet e gjendjes së luftës dhe asaj të jashtëzakonshme dhe atyre që kufizohen në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme. E drejta e mosdëbimit nga territori i shtetit (neni 39/1 i Kushtetutës), hyn në ato të drejta të cilat **nuk mund të kufizohen as në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme apo gjendjes së luftës që janë situatat më të rënda në lidhje me kufizimin e të drejtave të njeriut në një territor.**

Nga ana tjetër, ndonëse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk ka një dispozitë specifike ku të disponohet në mënyrë të shprehur në lidhje me të drejtën e shtetasve për të hyrë lirisht në territorin e tyre, ajo thekson që në hyrje të saj (neni) se Republika e Shqipërisë mbron të drejta kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj dhe të shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet, çka është një ndër parimet thelbësore të marrëdhënies së shtetësisë.

E drejta e lëvizjes lirisht brenda territorit të shtetit hyn në ato të drejta që mund të kufizohen, me kusht që kufizimet të jenë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, pra proporcionale, të diktuar nga rrethanat dhe të mos tejkalojnë kufizimet e parashikuara nga KEDNJ.

Me aktin normativ nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, qeveria shqiptare ka vendosur shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe kufizimin e të drejtave të garantuara nga nenet 37, 38, 41, pika 4, 49 dhe 51 të Kushtetutës⁵ deri në masën që konsiderohet e domosdoshme për të arritur ruajtjen e shëndetit të shtetasve. Edhe për këtë rast kufizimi duhet të jetë i tillë që të arrijë qëllimin e duhur, duke përdorur mjetet më pak çënuese të mundshme.

Një qasje e tillë rekomandohet fuqimisht edhe nga organizmat kryesore të të drejtave të njeriut, e më konkretisht si në deklaratën e Komisioneres së Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut znj. Michelle Bachelet,⁶ Komisioneres për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës znj. Dunja Mijatović⁷ dhe një grupi ekspertësh të Kombeve të Bashkuara⁸, i rekomandojnë autoriteteve shtetërore të shteteve të ndryshme, që në masat që do ndërmarrin për përballimin e pandemisë, të kenë në vëmendje respektimin e të drejtave të njeriut.

Me notën verbale të Misionit Permanent të Republikës së Shqipërisë pranë Këshillit të Evropës, të datës 31 Mars 2020, shteti shqiptar, në përputhje me nenin 15/3 të KEDNJ, i ka njoftuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës derogimin nga disa të drejta të parashikuara nga nenet e Koventës, për shkak të gjendjes së epidemisë,⁹ konkretisht: *e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 i KEDNJ), liria e tubimit dhe e organizimit (neni 11 i*

⁵ neni 37 – paprekshmeria e banesës e ndalimi i kontrollit vetjak jashtë procesit penal, neni 38- e drejta e vendbanimit dhe e lëvizjes së lirë, neni 41/4 –shpronësimet kundrejt vlerës së drejtë, neni 49 – e drejta e punës, neni -51 e drejta e grevës).

⁶ <https://www.unhcr.org/news/latest/2020/3/5e69eea54/coronavirus-outbreak-test-systems-values-humanity.html>

⁷ <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/we-must-respect-human-rights-and-stand-united-against-the-coronavirus-pandemic>

⁸ <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25722>

⁹ https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/declarations?p_auth=oC00wpDO

KEDNJ), mbrojtja e pronës (neni 1 i Protokollit shtesë të KEDNJ), e drejta për arsim (neni 2 i protokollit shtesë të KEDNJ), liria e lëvizjes (neni 2 i Protokollit Nr.4 të KEDNJ).

Siç vërehet, e drejta e shtetasve për të hyrë lirisht në territorin e shtetit (sipas nenit 3, pika 2 të Protokollit 4 të KEDNJ) nuk hyn në të drejtat nga të cilat shteti shqiptar ka deroguar për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Ajo është një e drejtë nga e cila nuk mund të hiqet dorë, e as nuk mund të kufizohet. Çdo kufizim i kësaj të drejte përbën tejkalim të kufizimeve të parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe aktet e tjera ndërkombëtare të sipërcituara.

Për sa më lart, duke marrë shkas nga zhvillimet e ditëve të fundit të bëra publike në media, sipas së cilave disa grupe me shtetas shqiptarë kanë mbetur të bllokuar me orë e ditë të tëra në kufirin tokësor me shtetin grek dhe shtetin malazez, shprehim qëndrimin tonë se veprimet e autoriteteve shqiptare për të mos lejuar hyrjen e këtyre shtetasve në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë veprime që çenojnë të Drejtat e Njeriut, pasi janë në kundërshtim me dispozitat e KEDNJ, të Kushtetutës, si edhe të detyrimeve që ka shteti për t’iu përgjigjur dhe marrë në mbrojtje shtetasit e tij.

Shtetasit shqiptarë të mbetur jashtë vendit mund të kenë mbetur pa mjete jetese si pasojë e masave të marra nga shtetet kundër COVID-19 (pa punë, pa ushqim, pa shtëpi). Atyre nuk mund t’u mohohet e drejta për t’u strehuar në vendin e tyre, çka nuk e përjashton aspak të drejten e shtetit shqiptar që të kërkojë prej tyre zbatimin rigoroz të masave të parashikuara nga aktet juridike përkatëse për vendosjen në karantinë, apo masa të tjeratë ligjshme. Kufizimi i të drejtave për shkak të fatkeqësisë natyrore, nuk mund të kalojë në kufijtë e absurdit duke iu mohuar atyre mundësinë për të gjetur strehë në tokën e atdheut të vet.

Lajmi se rreth 2000 shtetas janë riatdhesuar rreth një javë më parë nga vendet ku ata kishin mbetur të bllokuar, është një lajm tepër pozitiv që dëshmon se ka përpjekje konkrete të autoriteteve për t’iu ardhur në ndihmë shtetasve shqiptarë të mbetur jashtë vendit. Megjithatë, duhet të mbajmë në vëmendje se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë deklaroi që të gjithë janë të barabartë para ligjit. Vendimi i autoriteteve shqiptare duke i lejuar hyrjen në territorin shqiptar një pjese të shtetasve, e duke ia mohuar atë një pjese tjetër, formalisht duket se bie ndesh me këtë parim kushtetues.

Vetëkuptohet se rasti për të cilin po flitet nuk ka të bëjë me atë kategori individësh të cilët janë vendosur e stabilizuar me punë e banim në vende të ndryshme të botës, por me ata persona që për arsye të ndryshme janë larguar përkohësisht dhe aktualisht ndodhen jashtë territorit të vendit të tyre. Pikërisht kjo kategori shtetasish mundet që në këto kohë të vështira, të jashtëzakonshme, të ndodhet në kufijtë ekstremë të ekzistencës së tyre. Shteti shqiptar, shtetësinë e të cilit ata mbajnë, nuk mundet që t’i braktisë në fatin e vet fatal, duke iu mbyllur dyert e vendit të tyre. Dyert e Shqipërisë që është atdheu i tyre po aq sa i cilitdo prej nesh, përfshirë edhe vendimmarrësit, duhet të jenë të hapura për ta.

Autoritetet shqiptare nuk kanë bërë transparente apo publike kriteret mbi të cilat është realizuar “përzgjedhja” e shtetasve për riatdhesim. Siç edhe vetë autoritetet e kanë bërë me dije, kërkesat kanë qënë të shumta në numër, megjithatë vetëm një pjesë e shtetasve janë riatdhesuar.

Detyrimi që ne kemi për të riatdhesuar shtetasit tanë, kuptueshëm mund të kufizohet për shkak të mundësive efektive për ti kthyer ata, të kthyerit duhet t'i nënshtrohen rregullave strikte të vendosura për vendosjen në karantinë apo vetëizolim, ose izolimin në struktura të posaçme të karantinimit në se është rasti, por në asnjë rast nuk mund të ndalohet hyrja e shtetasve shqiptarë, që me mjetet e tyre kanë mundur të arrijnë në kufijtë e Republikës së Shqipërisë dhe kërkojnë të hyjnë në territor.

Pika 4 e aktit normativ Nr. 3, datë 15.3.2020¹⁰, të ndryshuar, përcakton saksionet në rast se shtetasit e ardhur nga jashtë vendit nuk zbatojnë masat e detyrueshme të vetkarantinimit apo të deklarimit se kanë ardhur nga jashtë shtetit. Por, ky akt normativ në asnjë rast nuk kufizon të drejtën e shtetasve shqiptarë për të hyrë në territor. Për rrjedhojë, ky akt duket se është formalisht në përputhje me dispozitat e analizuara më lart.

Megjithatë, nga organet ligjzbatuese përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për hyrjen në Republikën e Shqipërisë, rezulton se kjo pikë nuk po zbatohet si duhet, pasi *de facto* që prej disa ditësh kanë ndaluar hyrjen në territorin shqiptar të një pjese të shtetasve shqiptarë. Pra ky veprim ose është pasojë e zbatimit të gabuar të aktit normativ të sipërcituar, ose e ndryshimeve që mund të ketë pësuar akti, por të cilat nuk janë bërë publike (në lidhje më këtë opsion të dytë, informojmë se nga verifikimet e kryera në fletoren zyrtare deri në momentin e hartimit të kësaj shkresë, nuk rezulton që pika në fjalë e aktit normativ të mësipërm, të ketë pasur ndryshime për këtë çështje. Për rrjedhojë, kufizimi i të drejtës për hyrje të shtetasve në territorin e shtetit shqiptar nëpërmjet akteve të tjera administrative, qoftë të shkruara ose verbale, të autoriteteve përgjegjëse për rendin e sigurinë publike apo shëndetësinë, bie ndesh me përcaktimin e aktit të mësipërm, ose në opsionin e mungesës së aktit, do të përbënte ushtrim të paligjshëm të diskrecionit në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative.

Moslejimi i shtetasve për të hyrë në territorin e shtetit të tyre, edhe pse ata kanë mbërritur deri në kufi me mjetet dhe shpenzimet e tyre personale, nga informacioni që na është përcjellë deri tani, paraqet edhe një problem tjetër, atë të mosveprimit administrativ. Kjo pasi përveç cënimit të të drejtës kushtetuese të këtyre shtetasve për të hyrë në territor e vendit të tyre, atyre ju është mohuar edhe e drejta për një proces të rregullt ligjor. Më konkretisht autoritetet shtetërore gjatë zbatimit të masave, duhet të pajisin këta shtetas me aktet administrative përkatëse, si për veprime ashtu edhe për mosveprime. Kjo do të thotë se autoritetet shtetërore duhet të pajisin me një akt administrativ të arsyetuar, shtetasit të cilëve u mohohet e drejta e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky veprim administrativ lidhet ngushtë me të drejtën e këtyre shtetasve, për të kërkuar vënien në vend të së drejtës së tyre, apo kompensim për pasojat e rrjedhura nga kjo e drejtë e mohuara, pranë organeve administrative apo gjyqësore, vendase apo të huaja.

Institucioni ynë vlerëson se shteti shqiptar duhet të marrë menjëherë masat e nevojshme, për t'u siguruar që asnjë shtetasi shqiptar, që për çdo lloj arsyeje në këto kohë u ndodh jashtë vendit të vet, të mos i mohohet e drejta e hyrjes në territor. Pas hyrjes në territorin shqiptar, është e drejta e autoriteteve shtetërore të marrin të gjitha masat e nevojshme ligjore, për të siguruar ruajtjen e

¹⁰ “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” dhe konfirmuar me Vendimin e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile nr.1, datë 25.3.2020 “Për konfirmimin dhe vijimin e zbatimit të masave të veçanta administrative të marra gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”

shëndetit publik, përfshirë testimin e shtetasve të ardhur, apo vendosjen e tyre në një ambient karantinimi për periudhën e nevojshme kohore, por edhe garantimin e transportit të tyre nga pikat kufitare në një qendër urbane në kushtet e ndalimit të lëvizjeve për shkak të kufizimit të lëvizjes. Plani i masave i Komitetit të Përkohshëm “Për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri” apo i Komitetit Ndërmëtor të Emergjencave Civile, do të duhet të kishte parashikuar masa të qarta edhe për adresimin e kësaj çështje. Në çdo rast në gjykimin e Avokatit të Popullit, masat e marra për këtë çështje, s’mund e s’duhet të jetë lënia e tyre jashtë kufijve, pasi është joproporcionale, e në kundërshtim me të Drejtat e Njeriut, të sanksionuara në aktet e sipërcituara.

Së fundmi, rekomandojmë që në çdo rast, edhe për efekt të transparencës dhe informimit korrekt të qytetarëve, organet shtetërore dhe drejtuesit e tyre, të adresojnë në mënyrë korrekte, gjendjen e saktë juridike në të cilën ndodhet vendi, që është ajo e fatkeqësisë natyrore. Nevoja për të adresuar situatën me mjete të tjera juridike publike, apo me kufizime eventuale të mëtejshme, mund e duhet të bëhet gjithnjë në përputhje me kuadrin normativ ndërkombëtar të ratifikuar nga vendi ynë e kushtetues dhe që i përgjigjet situatës, e kjo është përgjegjësi e autoritetve shtetërore, e jo e drejtë e tyre.

Për sa më sipër Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDON:

Marrjen e masave të menjëhershme, për moscënimin joproporcional të së drejtës për hyrë në territor të shtetasve shqiptarë që kanë mbetur të bllokuar ditët e fundit në kufirin tokësor me shtetin grek dhe shtetin malazet, për shkak të masave të veçanta administrative të marra gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merren për zbatimin e tij, lutem të na vini në dijeni brenda afateve më të mira.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA

